

ÇFARË KA RËNDËSI PËR JU?

Vendosja nëse hospis është
zgjedhja e duhur për ju

UDHËZUES PËR BISEDRA



KY UDHËZUES ËSHTË MENDUAR TË
NXISË PACIENTËT TË EKSPLOROJNË
VLERAT, QËLLIMET DHE BESIMET E TYRE
RRETH HOSPIS. TEKNIKAT E TË FOLURIT
PËR TË NXITUR NDRYSHIM BAZOHEN
TEK UDHËZUESI I INTERVISTIMIT
MOTIVUES I SHKRUAR NGA
DR. KEN RESNICOW

FILLONI BISEDËN



KA SHUMË FAKTORË PËR T'U MARRË NË KONSIDERATË.
MUND TË FLASIM PËR AQ KOHË SA JU DËSHIRONI.
MUND TË NDALUJMI SË FOLURI PËR KËTË TEMË KUR
TË DËSHIRONI.*

ÇFARË ËSHTË HOSPIS?

Qëllimi i hospis është të përmirësojë cilësinë e jetës suaj në muajt, javët dhe ditët e fundit. Hospis mund t'ju japë qetësi mendore për t'u fokusuar te gjërat që kanë më shumë rëndësi për ju. Gjatë qëndrimit tuaj në hospis do të vazhdoni të merrni cilësinë më të lartë të kujdesit. Do të merrni mbështetje emocionale, psikologjike dhe shpirtërore. Familja juaj do të marrë mbështetje shpirtërore dhe mbështetje në lidhje me përkujdesjen.

Hospis i jep rëndësi kujdesit, komfortit dhe mbështetjes në vend të trajtimeve të tilla si, kimioterapia dhe rrezatimi në rastin e pacientëve që janë afër fundit të rrugëtimit të jetës së tyre. Gjatë kësaj kohe hospis mund të ofrojë shumë, si për shembull menaxhimin e dhimbjes dhe pakësimin e ankthit. Fokusi është tek të jetuarit më gjatë, në mënyrë komode dhe me dinjitet.

KU OFROHET HOSPIS?

Zakonisht, kujdesi hospis ofrohet në shtëpinë tuaj, në shtëpinë e një anëtarit të familjes ose në shtëpinë e një miku.

SI TË PAGUAJ PËR HOSPIS?

Pjesa më e madhe e shërbimeve mbulohen nga Medicare, Medicaid dhe kompani private të sigurimit por mund të ketë edhe shpenzime nga xhepi. Ju nuk mund të refuzoheni nga asnjë hospis bazuar në aftësinë tuaj për të paguar. Hospis është me dëshirë. Ju mund të qëndroni në kujdesin hospis për sa kohë që kualifikoheni. Gjithashtu, mund ta anuloni atë në çdo kohë dhe për çfarëdolloj arsyeje.

*Shënim: Jepni aq informacion sa i nevojitet pacientit.

EKSPLORONI DHE KUPTONI



SA PËR TA DITUR, NUK KA PËRGJIGJE TË SAKTA APO TË GABUARA.

MË TREGONI PAK PËR VETEN DHE RRUGËTIMIN TUAJ ME KANCERIN.

SI TA DI NËSE HOSPIS ËSHTË KUJDESI I DUHUR PËR MUA?

Vendosja nëse hospis është zgjedhja e duhur për ju dhe familjen tuaj nuk është e lehtë. Është normale që familjet të përjetojnë emocione të forta gjatë kësaj kohe. Mund të ndjeni se nuk jeni gati për të folur me anëtarët e familjes suaj rreth mundësisë së të pasurit nevojë për hospis. Mund të ndiheni të dyzuar, të pasigurt dhe të frustruar. Mund të ndiheni të shqetësuar, të ngarkuar dhe të frikësuar.

REFLEKTONI: Duket sikur ndiheni.....

I vetmuar	I shkuraçar	I këputur
I frikësuar	I frustruar	I ngarkuar
I pashpresë	I ngarkuar	I humbur
I pafuqishëm	I sfiduar	I lodhur
I pasigurt	Nuk dëshironi të mërzisni familjen	

PYESNI: Pse e thatë atë?

PYESNI: Si ishte kjo për ju?

STRUKTURONI BISEDËN RRETH VLERAVE TË RËNDËSISHME



MË TREGONI PAK SE ÇFARË KA MË SHUMË RËNDËSI PËR JU DHE FAMILJEN TUAJ.

PYESNI: Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që dëshironi në fund të jetës? Sa besim keni se do të jeni në gjendje t'i arrini ato?

PYESNI: Keni ndonjë pyetje specifike rreth hospis?

REFLEKTONI: Duket sikur nuk ndiheni plotësisht rehat për të folur rreth hospis. Duket sikur nuk e keni të lehtë të mendoni për hospis.

Shpesh, njerëzit shprehen si më poshtë kur mendojnë për fundin e rrugëtimit të jetës:

- “Dua t’u them lamtumirë të gjithëve atyre që dua, të shikoj për herë të fundit oqeanin, të dëgjoj muzikë, e të shkoj.”
- “Dua të jem i qetë, pa dhimbje, të mos lë asgjë pa thënë.”
- “Dua të jem i rrethuar nga familja ime, në shtëpinë time.”

PYESNI: Cilat nga sa më poshtë kanë më shumë rëndësi për ju?

VLERAT KRYESORE, QËLLIMET DHE ARSYET PËR TË FOLUR RRETH HOSPIS:

Të qenit një prind i mirë

Të qenit i fortë

Arsye financiare

Të qenit në kontroll kur të vijë momenti

Të qenët i organizuar

Dëshira për të qenë pozitiv

Të qenit një bashkëshort/partner i mirë

Të qenit i respektueshëm

Ana shpirtërore/Feja

Të qenit në paqe kur të vijë momenti

Dëshira për të mos u perceptuar si barrë

Dëshira për qetësi mendore

BËNI BISEDË QË NXISIN NDRYSHIM

“

KENI BISEDUAR NDOJËHERË ME FAMILJEN TUAJ RRETH KUJDESIT TUAJ NË FUND TË JETËS?

KENI BISEDUAR NDOJËHERË ME NJË MJEK RRETH KUJDESIT TUAJ NË FUND TË JETËS?

A ËSHTË HOSPIS KUJDESI I DUHUR PËR MUA?

PYESNI: Si funksionoi?

PYESNI: Pse u ndiet kështu?

REFLEKTONI: Po filloni të mendoni se nuk dëshironi të shqetësoheni më. Pasiguria ka filluar t'ju shqetësojë pak më shumë.

Ndoshta ndjenja e pasigurisë për të ardhmen ka filluar t'ju shqetësojë. Mund të ndiheni sikur nuk doni më të shqetësoheni gjatë gjithë kohës. Mund të pyesni veten se si mund të jetë nëse filloni të planifikoni të ardhmen.

HAPAT VIJUES

“

ËSHTË MIRË TË FLITET PËR KËTO TEMA TË VËSHITURA EDHE NËSE NUK MERRET NJË VENDIM SOT RRETH HOSPIS.

EKIPI JUAJ I ONKOLOGJISË KA INFORMACION SE SI HOSPIS MUND T'JU NDIHMOJË JU DHE FAMILJEN TUAJ.

“ÇFARË NDODH MË PAS?”

PYESNI: Gjatë kësaj bisede, a u prekën çështje të tjera për të cilat keni menduar së fundmi por për të cilat nuk folëm sot?

REFLEKTONI: Duket se dëshironi të mendoni për...

HAPAT VIJUES:

Do të marr më shumë kohë për të menduar për atë që dua në fund të jetës

Do të flas me anëtarët e familjes sime dhe me miqtë e mi

Do të flas me partnerin/ bashkëshortin/bashkëshorten

Do të flas me onkologun tim

REFLEKTONI: Duket sikur dëshironi të diskutoni qëllimet tuaja të kujdesit me familjen tuaj.

MOOC
MICHIGAN ONCOLOGY
QUALITY CONSORTIUM



**Blue Cross
Blue Shield**
of Michigan

Nonprofit corporations and independent licensees
of the Blue Cross and Blue Shield Association